



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/02

Datë: 05.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020 - 2023.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/02

Datë: 05.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 25,000.00 € (njëzetepesë mijë euro) familjes së Agon Musliut, i cili humbi jetën tragjikisht me datë 3 maj 2020 në Qendrën e Studentëve në Prishtinë, e caktuar si Hapësirë Karantine.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve Rezervat dhe transferohen te nën programi Thesari me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere.
3. Mjetet financiare nga pika 2. e këtij vendimi transferohen në llogarinë e familjarëve të përcaktuar sipas të dhënave bankare bashkëngjitur këtij vendimi.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Thesari i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/02

Datë: 05.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të bëjë ndryshimin dhe tejkalimin e përkohshëm të rregullave fiskale të deficitit si dhe kufizimit të bilancit bankar të përdorshëm, sipas nenit 22B të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007.
2. Tejkalimi sipas pikës 1 të këtij Vendimi tek kufiri i deficitit rritet përkohësisht deri në gjashtë pikë pesë për qind (6.5%), ndërsa kufiri i bilancit të shfrytëzueshëm bankar ulet përkohësisht deri në tre për qind (3%).
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit që të procedojë këtë Vendim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
4. Ky vendim shfuqizon Vendimin Nr. 03/23 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 08.04.2020.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Meqë disa nga parametrat makro-fiskal të paraqitur në Tabelën Nr. 1 të Ligjit Nr. 07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Vitin 2020 ndikohen nga situata e pandemisë globale "Covid-19", nevojitet të ndryshohen përkohësisht disa nga rregullat fiskale të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar. Në pajtim me nenin 22B (Rritja e përkohshme e kufirit të deficitit) këto ndryshime paraqiten për aprovim.

Për mbulimin e rritjes së deficitit sipas këtij propozimi, Ministria e Financave ka identifikuar burime shtesë të financimit të deficitit, i cili do të financohet nga burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit, përmes letrave me vlerë, kredive ndërkombëtare si dhe granteve.

Ky vendim parasheh edhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 03/23 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 08.04.2020, për shkak se janë përditësuar parashikimet dhe janë reflektuar parametrat e rishikuar makroekonomik.

**Avdullah HOTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë